

**SHOQËRIA E BASHKËPUNITIT BUJQËSOR
“AGRO-GJONI”**



AKTI I THEMELIMIT



Four handwritten signatures in blue ink, arranged horizontally from left to right. The signatures are stylized and cursive, typical of legal documents.

Në Tiranë, sot në datën 19/03/2018, nismëtarët e mëposhtëm:

1. GJON NDREC GJONI
2. NDUE NDREC GJONI
3. ELONA SHPËTIM ÇAUSHI
4. MAJLINDA GJON THOMPSON
5. FRAN GJON GJONI
6. DEDAN NDUE GJONI
7. LEKE GJON GJONI

I. Themelimi

Vendosin themelimin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor AGRO-GJONI (“Shoqëria”), bazuar në ligjin nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”. Themeluesit kanë vendosur të organizohen vullnetarisht me qëllim përmbushjen e nevojave dhe interesave të tyre në fushën e hortikulturës në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, si dhe me çdo vendim të organeve të shoqërisë. Shoqëria do të ushtrojë veprimtari për një periudhë të pacaktuar.


II. Deklarata e anëtarësisë

Anëtarët themelues, me anë të nënshkrimit të aktit të themelimit, deklarojnë se përmbushin kriteret për të qenë anëtarë të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “AGRO-GJONI” dhe pranojnë që të zbatojnë aktin e themelimit, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë si dhe të zbatojnë standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga anëtarësia në shoqëri. Anëtarët, gjithashtu deklarojnë që në dijeninë e tyre nuk ekziston asnjë shkak që kufizon anëtarësinë e tyre në shoqëri.

III. Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Mine Peza”, Pallati Nr.87/3, Hyrja 1, Kati I-rë, Tiranë.

IV. Objekti



4.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e veprimtarive si më poshtë:

- i. Kultivimi i farave, drurëve frutorë, drurëve dekorativ.
- ii. Prodhim i fidanëve, bimëve të arave, magazinimi i tyre, tregtimi me shumicë dhe pakicë.
- iii. Përdorim i plehrave kimikë, pesticideve, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprures dhe në interes të shoqërisë, në fushën agro ushqimore.
- iv. Import dhe eksport.
- v. Lidhja e marrëveshjeve me shoqëri analoge në vend dhe jashtë vendit.
- vi. Organizimi i veprimtarive edukuese dhe trajnimeve të specializuara të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e shoqërisë.

4.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:

- i. Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
- ii. Të kryejë çdo veprim në përmbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- iii. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.
- iv. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.

4.3 Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizik ose juridik, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".

4.4. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

4.5. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.

4.6. Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizik ose juridik, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".


V. Statuti

Anëtarët Themelues kanë rënë dakort për miratimin e statutit të shoqërisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti themelimi të nënshkruar rregullisht nga ortakët.

VI. Kapitali i regjistruar

Vlera e Kapitalit të regjistruar të shoqërisë është **100000 Leke**(te reja). Kapitali ndahet në **100kuota**, me vlere nominale **1000 Leke** secila, të nënshkruara dhe të shlyera plotësisht nga anëtarët themelues si më poshtë vijon:

<i>Anëtari</i>	<i>Kuota</i>	<i>Përqindja e zotëruar</i>	<i>Kontributi ne Leke</i>
1. Gjon Gjoni	14,286	14,286	14286
2. Ndue Gjoni	14,286	14,286	14286
3. Elona Çausi	14,286	14,286	14286
4. Majlinda Thompson	14,286	14,286	14286
5. Fran Gjoni	14,286	14,286	14286
6. Dedan Gjoni	14,286	14,286	14286
7. Leke Gjoni	14,286	14,286	14286
Totali	100	100	100000



VII. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, të Drejtat dhe Detyrimet e të cilit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emerimit të tij.

Administrator i Shoqërisë është:

Zoti **Gjon Gjoni**, lindur në Gojan, Puke, Shqipëri më datë 31/10/1938, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030884187, me numër personal D81031003I, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore, me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

Me datën 19/03/ 2018, në Tirane, u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lire të anëtarëve themelues, ky Akt Themelimi i Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "AGRO-GJONI".

ANËTARËT THEMELUES

1. **GJON NDREC GJONI**

Gjon Gjoni

2. **NDUE NDREC GJONI**

Ndue Gjoni

3. **ELONA SHPËTIM ÇAUSHI**

Elona Çaushti

4. **MAJLINDA GJON THOMPSON**

Majlinda Thompson

5. **FRAN GJON GJONI**

Fran Gjoni

6. **DEDAN NDUE GJONI**

Dedan Gjoni

7. **LEKE GJON GJONI**

Leke Gjoni

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me date 20.03.2018 (dymije e tetembedhete) ne Dhomen e Noterise Tirane dhe para meje noteres se kesaj dhome te quajtures, Violeta Sulkaç ,me seli ne rrugen Sulejman Delvina ,Tirane u paraqiten personalisht:

Gjon Gjoni i biri i Ndreç, me datelindje 31.10.1938, lindur ne Puke dhe banues ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **D81031003I**

Ndue Gjoni i biri i Ndreç, me datelindje 26.09.1948, lindur ne Lezhe dhe banues ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **E80926020W**

Dedan Gjoni i biri i Ndue, me datelindje 25.02.1976, lindur ne Treshane dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **H60225182S**

Leke Gjoni i biri i Gjon, me datelindje 15.01.1966, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **G60115154C**

Fran Gjoni i biri i Gjon, me datelindje 13.06.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **G80613175Q**

Majlinda Thompson e bija e Gjon, me datelindje 31.03.1984 lindur ne Treshane dhe banuese ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **I45331066A**

Elona Çausi e bija e Shpetim, me datelindje 24.05.1971 lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr personal **H15524060L**

Per identitetin e te cilës u sigurova ne baze te leternjoftimit personal dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftësitë e ligjit, me kërkesën e saj i vërtetova nënshkrimin e vene tek **Akt Themelimi i Shoqerise se Bashkepunimit Bujqesor "AGRO-GJONI"**

NOTERE
Violeta SULKAJ